

VENDIM
Nr.51, datë 16.1.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË SIPËRFAQES DERI 1000 HA NË KOMUNAT SYNEJ, LUZ I VOGËL, KRYEVIDH DHE
GOSË, KAVAJË, PËR KULTIVIMIN E ULLIRIT, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 3, 5, pika 3, 23, pika 3, shkronja “b”, e 27, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të sipërfaqes deri 1000 ha, pronë shtetërore, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevidh dhe Gosë, Kavajë, në kuadër të nismës “Shqipëria 1 euro”, për kultivimin e ullirit, është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Miratimin e bonusit prej 9 për qind të pikëve, për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “AGROTAL – 1” sh.a., Tiranë.

3. Kohëzgjatja e koncesionit të përcaktohet gjatë hartimit të kontratës.

4. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha